



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 279 Prot.

Tiranë, më 15.02.2019

V E N D I M

Nr.9, Datë 15/02/2019

**PËR
MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË MBIKËQYRJES SË
ADMINISTRIMIT TË SHËRBIMIT CIVIL NË NJËSINË E VETËQEVERISJES
VENDORE, BASHKIA KOLONJË DHE PARALAJMËRIMIN E INSTITUCIONIT
PËR TË RREGULLUAR GJENDJEN E
LIGJSHMËRISË.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me mbikëqyrjen e zhvilluar në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Kolonjë,

VËREJ SE:

Me Vendimin nr. 67, datë 22.06.2018, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil, në njësinë e qeverisjes vendore, Bashkia Kolonjë”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në institucionin Bashkia Kolonjë.

Objekti i mbikëqyrjes është i përgjithshëm dhe përfshin veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në

proceset e administrimit të shërbimit civil, prej momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, e në vijim.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes nr. 538/1 prot., datë 22.06.2018, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili me shkresën nr. 538/2 prot., datë 22.06.2018, “Njoftim në lidhje me mbikëqyrjen në Bashkinë Kolonjë”, i është njoftuar Bashkisë Kolonjë.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projekt raportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil dhe ia ka dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën 538/3 prot., datë 13.12.2018, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, “Dërgohet projekt raporti në përfundim të mbikëqyrjes në institucionin Bashkia Kolonjë, në lidhje me administrimin e shërbimit civil”, duke i lënë një afat 20 ditë kohë, për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes.

Ndërkohë, subjekti i mbikëqyrur, pasi është njohur me materialin, nëpërmjet shkresës nr. 2372/1 prot., datë 31.12.2018, “Dërgim projekt raporti”, ka dërguar projekt raportin e nënshkruar nga personat përgjegjës, bashkëlidhur edhe observacionet përkatëse, në përmbajtjen e të cilave është njoftuar Komisioneri për fillimin e veprimeve administrative për rregullimin e situatës. Por, ndërkohë, konstatohet se observacionet nuk janë shoqëruar me aktet administrative që vërtetojnë masat e marra dhe për këtë arsye verifikimi i tyre do të realizohet pas përfundimit të afatit të vendosur nga Komisioneri për zbatimin e vendimit.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, referuar Seksionit III, “Procedura hetimore”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Të miratoj përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme, në lidhje me administrimin e shërbimit civil, në Bashkinë Kolonjë, dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave që do të specifikohen më poshtë.
2. Të konstatohet pavlefshmëria absolute e akteve të emërimit (25 raste) nga Kryetari i Bashkisë Kolonjë, sipas orientimeve në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe të rregullohen pasojat, duke i ndërprerë marrëdhënien e punës dhe atë financiare me institucionin, punonjësve të emëruar në kundërshtim me procedurën e përcaktuar në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të cilët janë evidentuar në vijim sipas emrit, pozicionit të punës dhe aktit të emërimit të nxjerrë nga titullari i institucionit:
 1. *****, Specialist për Arsimin, Kulturën dhe Sportet, emëruar me aktin nr.351, datë 31.10.2017.
 2. *****, Specialisti Auditit dhe Sinjalizimeve, emëruar me aktin nr. 118, datë 24.06.2016.
 3. *****, Specialist i Auditit dhe Sinjalizimeve, emëruar me aktin nr. 48, datë 22.02.2017.
 4. *****, Drejtor, Drejtoria Financës, emëruar me aktin nr. 166, datë 18.08.2016.
 5. *****, Specialist për Licencimin, marrëdhënien me Donatorët dhe Lidhjen e Kontratave, emëruar me aktin nr. 17, datë 25.01.2018.
 6. *****, Specialiste për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit, emëruar me aktin nr. 116, datë 10.04.2017.
 7. *****, Specialist për Zhvillimin e Projekteve, emëruar me aktin nr. 20, datë 31.01.2017.
 8. *****, Specialist për Menaxhimin e Pronave Publike, emëruar me aktin nr. 90, datë 20.03.2017.
 9. *****, Specialist Topograf, emëruar me aktin nr. 114, datë 21.11.2015.
 10. *****, Përgjegjës i Sektorit të Bujqësisë, Pyjeve e Kullotave dhe Mbrojtjes së Tokës, emëruar me aktin nr. 10, datë 21.04.2014.
 11. *****, Specialist Topograf, emëruar me aktin nr. 117, datë 24.06.2016.
 12. *****, Specialiste për Investime dhe Mirëmbajtje, emëruar me aktin nr. 7, datë 28.02.2014.
 13. *****, Specialist për Planifikimin e Punëve Publike, emëruar me aktin nr. 128, datë 05.07.2016.
 14. *****, Përgjegjës Sektori në Agjencinë e Pyjeve dhe Kullotave, emëruar me aktin nr. 252, datë 27.07.2017.
 15. *****, Specialist për Menaxhimin Pyjor, emëruar me aktin nr. 449, datë 14.05.2015.

16. *****, Specialist i Investimeve Private, emëruar me aktin nr. 330, datë 16.10.2017.
17. *****, Specialist i Zonë Pyjore, emëruar me aktin nr. 331, datë 16.10.2017.
18. *****, Specialist i Zonës Pyjore, Njësia Administrative Çlirim, emëruar me aktin nr. 178, datë 01.09.2016.
19. *****, Specialist i Zonës Pyjore, Njësia Administrative Qendër, emëruar me aktin nr. 178, datë 01.09.2016.
20. *****, Specialist i Zonës Pyjore, Njësia Administrative Novoselë, emëruar me aktin nr. 7, datë 11.01.2016.
21. *****, Specialist i Ndhmës Ekonomike, emëruar me aktin nr. 53, datë 22.02.2017.
22. *****, Specialist Kadastre, emëruar me aktin nr. 4, datë 12.01.2017.
23. *****, Specialist i Ndhmës Ekonomike, emëruar me aktin nr. 62, datë 28.02.2017.
24. *****, Specialist i Protokoll Arkivit, emëruar me aktin nr. 239, datë 16.11.2016.
25. *****, Specialist i Zonës Pyjore, Njësia Administrative Çlirim, emëruar me aktin nr. 178, datë 01.09.2016.

- Njësia përgjegjëse, të planifikojë ecurinë e kësaj procedure, me qëllim që procesi i konstatimit si absolutisht të pavlefshëm të akteve të nxjerra nga Kryetari i Bashkisë, të kryhet në mënyrë të alternuar me procesin e shpalljes së pozicioneve të lira dhe fillimin e procedurës së konkurrimit, sipas neneve 22, 23, e vijues, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, sipas orientimeve në raportin e mbikëqyrjes.
 - Në zbatim të detyrimit ligjor, njësia përgjegjëse të hartojë për vitin 2018, planin e punës së pranimeve në shërbimin civil, për zhvillimin e procedurave të konkurrimit, për pozicionet që do të mbeten të lira pas ekzekutimit të këtij vendimi, zbatimi i të cilit do të ndiqet nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, duke mbajtur parasysh orientimet, në pikat më sipër të këtij vendimi.
3. Pozicionet e punës, “Sekretar i Përgjithshëm”, “Drejtor, Drejtoria Juridike dhe e Personelit”, “Specialist për Informacionin dhe Shërbimeve për Qytetarin”, “Përgjegjës për Sektorin e Koordinimit, Zhvillimit dhe Turizmit”, “Përgjegjës në Sektorin e Mirëqenies Sociale”, “Drejtor, Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Mbrojtjes së Territorit”, “Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit, Zhvillimit dhe Mbrojtjes së Territorit”, Specialisti i “Planifikimit dhe të Menaxhimit të Mbetjeve Urbane” dhe “Specialist i Ndhmës Ekonomike në Njësia Administrative Leskovik”, të shpallen të lira dhe të vijojnë procedurat e rekrutimit në përputhje me legjislacionin e shërbimit civil dhe në koherencë me strukturën dhe nevojat aktuale të institucionit.

4. Të evidentohet e veçuar në strukturën organizative të institucionit kategoria e pozicioneve të shërbimit civil, nga pozicionet e tjera të punës, që kryejnë funksione politike dhe pozicionet që nuk ushtrojnë funksion publik (*punonjësit administrativë*).

Për pozicionet e punës me emërtesën aktuale “*Jurist*” apo “*Topograf*”, njësia përgjegjëse të hartojë formularin e përshkrimit të punës dhe të realizojë ekuivalentimin (*njehsimin*) e tyre me emërtesat e pozicioneve të punës të përcaktuara në nenin 19, pika 7, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar dhe pikën 5, të kreut II, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i ndryshuar, në kategorinë ekzekutive (specialist).

5. Në rastin e punonjësës ******, me detyrë “*Specialiste e Protokollit*”, njësia përgjegjëse duhet të anulojë aktin e deklarimit të statusit të punësimit të saj si nëpunës civil në periudhë prove, për shkak se punonjësja ushtron detyrat e saj, në një pozicion pune, i cili nuk përfshihet në fushën e shërbimit civil dhe të vazhdojë marrëdhënia e punësimit, sipas parashikimeve ligjore në fuqi.
6. Njësia e burimeve njerëzore të institucionit, të drejtojë procesin e hartimit të përshkrimeve të punës për të gjitha pozicionet e shërbimit civil, në bashkëpunim me subjektet e tjera të ngarkuara me ligj për menaxhimin e këtij procesi (*analisti i punës, eprori direkt dhe drejtori i përgjithshëm*), sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në vendimin nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i ndryshuar dhe lidhjeve të cilat janë pjesë e këtij vendimi, si dhe udhëzimit nr. 1, datë 31.5.2017, të Departamentit të Administratës Publike.

Për plotësimin e këtij detyrimi, njësia përgjegjëse, të zbatojë orientimet që janë dhënë në rubrikën përkatëse të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

Formulari i përshkrimit të punës i nënshkruar nga subjektet e përcaktuara nga ligji, të bëhet pjesë e dosjes së personelit të çdo nëpunësi civil dhe të mbahet parasysht gjatë procesit të miratimit të strukturës përfundimtare të institucionit, si një detyrim ligjor që rrjedh prej ligjit që rregullon funksionimin e njësive vendore, i cili ka përcaktuar vitin 2018, si afatin e strukturimit përfundimtar të këtyre njësive, pas implementimit të reformës territoriale.

Një kopje e përshkrimeve të punës, të depozitohet në arkivin e institucionit.

Njësia përgjegjëse, të njoftojë të gjithë subjektet që ligji i ngarkon me administrimin e aspekteve të veçanta të shërbimit civil, e në rastin konkret, me procesin e hartimit dhe miratimit të përshkrimit të punës.

7. Njësia e burimeve njerëzore e institucionit, në respektim të procedurave të hollësishme të parashikuara në vendimin nr. 109, datë 26.2.2014 të Këshillit të Ministrave, *“Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”*, i ndryshuar dhe lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të udhëheqë procesin e vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë, për 6 mujorin e dytë të vitit 2018, si dhe të ndjekë procesin në të ardhmen për realizimin e tij, brenda afateve.

Në përfundim të procesit, formulari i vlerësimit për çdo nëpunës civil, të përfshihet në Regjistrin Qendror të Personelit, siç parashikohet në pikën 18, të kreut II, të aktit nënligjor si më sipër.

Të njoftohen të gjithë menaxherët në rolin e zyrtarit raportues/zyrtarit kundërfirmues/zyrtarit autorizues, me qëllim që të realizojnë detyrat që i ngarkon ligji dhe aktet nënligjore, të cilët do të mbajnë përgjegjësi personale në rast të mos zbatimit të detyrave të lëna në këtë vendim.

8. Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit, të plotësojë dosjen e personelit të çdo nëpunësi civil, duke përfshirë në të, të gjitha dokumentet dhe të dhënat sipas lidhjeve 1 e 2, pjesë e Vendimit nr. 117, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”*, si dhe ato të evidentuara në mungesë në tabelat aneks, të cilat janë pjesë e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

9. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **3 muaj** nga marrja dijoni për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në orientimet e dhëna në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

10. Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, njësia e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Kolonjë, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.

11. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Kolonjë, duke i dërguar një kopje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe njëkohësisht, të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë.

12. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit

civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha